VENDIM
Nr.135, datë 11.2.2009

PËR MBYLLJEN E AKADEMISË SË POLICISË "ARBEN ZYLYFTARI" DHE RIORGANIZIMIN E ARSIMIMIT POLICOR SI PJESË PËRBËRËSE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari", si institucion i arsimit të lartë, për shkollimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, dhe riorganizimin e arsimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Arsimimi policor të riorganizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në përputhje me ligjin nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit".

3. Vendimi nr.281, datë 2.6.2000 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha